



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik/Municipality of Kačanik



01.Nr. 60/01-12895/20
Kačanik, 30.06.2020

STATUTI **I KOMUNËS SË KAÇANIKUT**

(Teksti i spastruar sipas Statutit 01.Nr.60/01-12895/20 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Statutit të Komunës së Kaçanikut 01.Nr.3588/2008 të datës 25.09.2008)

Kaçanik, Qershor 2020

Faqe 1 nga 21

Adresa: Rr. "Qamil Ilazi" Nr. 28, 71000 Kačanik.

Kuvendi i Komunës së Kaçanikut në mbështetje të dispozitave të nenit 12.2 dhe 12.3 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe në bazë të mandatit të dhënë Kuvendeve të Komunave të Republikës së Kosovës për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes lokale, në mbledhjen e mbajtur më 30.06.2020, miratoi:

S T A T U T I N
E
KOMUNËS SË KAÇANIKUT

PJESA E PARË

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Statuti i Komunës është akti më i lartë juridik i komunës që miratohet nga Kuvendi i Komunës, në pajtim me legjislacionin në fuqi që e rregullon organizimin e brendshëm të komunës. Në përdorimin e mëtutjeshëm do të njihet si Statuti i Komunës.

Neni 2

1. Përgjegjësitë e komunës ushtrohen, organizohen dhe menaxhohen në pajtueshmëri të plotë me ligjet të cilat rregullojnë përgjegjësitë e komunës, në pajtueshmëri me këtë statut dhe rregulloren e punës të miratuar nga Kuvendi i Komunës.
2. Me këtë statut rregullohen: kompetenca dhe pushteti i komunës, pjesëmarrja e drejtpërdrejtë e qytetarëve në mbledhje, aktivitetet dhe mënyra e vendosjes në punët publike, organet e komunës, shërbimi civil, të drejtat dhe detyrat e anëtarëve të kuvendit, administrimi financiar, konflikti i interesave, aktet formale, dokumentet zyrtare dhe informatat.

Neni 3

Komuna ka statusin e personit juridik, të drejtën për të poseduar dhe administruar pronën, mundësinë për të ushtruar padi, për të qenë e paditur në gjykata, të drejtën për të lidhur kontrata dhe të drejtën për të marrë punëtorë në punë. Mundë të jetë pronare apo bashkëpronare e ndonjë kompanie që është në interes të komunës në raport me qytetarët.

Neni 4

1. Statuti i Komunës zbatohet vetëm brenda kufijve të Komunës së Kaçanikut.

2. Komuna mund të hyjë në marrëdhënie kontraktuese me komunitat tjera në pajtueshmëri me ligjet në fuqi.

Neni 5

Organet e komunës janë:

Kuvendi i Komunës- është organi më i lartë legjislativ i komunës;

Kryetari i Komunës- është organi më i lartë ekzekutiv i komunës.

Neni 6

1. Brenda territorit të saj komuna ushtron përgjegjësitë të cilat nuk i janë rezervuar shprehimisht me ligj të pushtetit qendror si dhe ato të deleguara nga pushteti qendrorë.
2. Komuna brenda territorit të vet, është përgjegjëse për:
 - a. Ofrimin e kushteve themelore për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik;
 - b. Planifikimin urban dhe rural dhe shfrytëzimin e tokës;
 - c. Lëshimin e lejeve për ndërtim dhe zhvillime tjera;
 - d. Mbrojtjen lokale të ambientit;
 - e. Zbatimin e rregullave të ndërtimit dhe standardeve për kontrollin e ndërtimit;
 - f. Ofrimin e shërbimeve publike lokale dhe të infrastrukturës duke përfshirë furnizimin me ujë, ujësjellësin dhe kanalizimin, përpunimin e ujërave të zeza, mirëmbajtjen e rrugëve lokale, transportin lokal dhe menaxhimin e mbeturinave;
 - g. Shërbimet publike duke përfshirë shërbimet e zjarrfikësve dhe të emergjencës lokale;
 - h. Udhëheqjen e pronës së komunës;
 - i. Shkollimin parashkollor, fillor dhe të mesëm, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve edukative, punësimin, shpërblimin dhe trajnimin e instruktorëve dhe administratorëve të arsimit;
 - j. Zgjedhjen e drejtorit ose zëvendës drejtorit të institucioneve edukative arsimore në nivelet 0, 1, 2 dhe 3 në pajtim me procedurat ligjore të rekrutimit dhe kriteret ligjore të përcaktuara nga MASHT;
 - k. Kujdesin primar shëndetësor;
 - l. Ofrimin e shërbimeve familjare dhe shërbimeve tjera sociale siç është strehimin familjar, përkujdesen fëmijërorë, përkujdesen për të moshuarit duke përfshirë edhe regjistrimin dhe licencimin e këtyre qendrave, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e profesionistëve të mirëqenies sociale;
 - m. Mbrojtjen e konsumatorëve dhe shëndetin publik;
 - n. Licencimin e shërbimeve publike dhe objekteve duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me argëtimin, aktivitetet kulturore dhe ato të lira, ushqimin strehimin, tregjet, shitësit në rrugë, transportin lokal publik, taksitë, gjuetinë, peshkimin, restorantet, hotelet, dhe turizmin;
 - o. Emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve, rrugicave dhe të vendeve tjera publike;
 - p. Sigurimin dhe mirëmbajtjen e parqeve publike, hapësirave të hapura dhe varrezave dhe

- q. Aktivitete tjera të ngjashme dhe të rëndësishme për administrimin adekuat të territorit të komunës që nuk janë përcaktuar me Ligj dhe këtë Statut.
3. Komuna është përgjegjëse edhe për çështje të tjera të deleguara nga autoritetet qendrore të Republikës Kosovës të përcaktuara në nenin 18 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale.

Neni 7

1. Komuna ka emblemën, shenjat dhe simbolet e veta të përcaktuara me vendim të posaçëm të Kuvendit të Komunës.
2. Asnjë subjekt dhe person tjetër përveç komunës nuk mund ta përdorë emblemën dhe shenjat komunale apo simbolet pa autorizim paraprak të dhënë nga organet kompetente komunale.
3. Përmbajtja, përdorimi dhe ndryshimi i emblemës dhe simboleve do të përcaktohet me vendim të veçantë të Kuvendit të Komunës në pajtim me Ligjin.

Neni 8

Komuna e ka vulën e vet, të rrumbullaket dhe katrore të formateve standarde. Mënyra e mbajtjes dhe përdorimit të vulave përcaktohet me vendim të posaçëm të Kuvendit të Komunës.

Neni 9

Komuna ka festat e veta. Festat e Komunës së Kaçanikut janë:

- 11 qershori –Dita e çlirimit të komunës dhe
- 10 gushti - Dita e dëshmorëve të “Brigadës 162 të UÇK-së”- Dita e dëshmorëve të komunës.

Neni 10

Kuvendi i Komunës dhe Kryetari ndajnë shpërblime, mirënjohje dhe falënderime. Mënyra dhe procedura e ndarjes së tyre rregullohet me vendim të veçantë të Kuvendit të Komunës.

Neni 11

Kuvendi i Komunës për kontribut të veçantë në zhvillimin e komunës mundë të shpallë qytetarë nderi të Komunës së Kaçanikut personalitete të ndryshme brenda dhe jashtë vendit.

PJESA E DYTË

PROCEDURAT PËR NDRYSHIM DHE PLOTËSIM TË STATUTIT TË KOMUNËS

Neni 12

1. Iniciativa për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës mund të ndërmerret nga:
 - a. Kryetari i Komunës;
 - b. 1/3 e anëtarëve të Kuvendit të Komunës;
 - c. Me iniciativën e 15% të qytetarëve me të drejtë vote në komunë.

Faqe 4 nga 21

Adresa: Rr. “Qamil Ilazi” Nr. 28, 71000 Kaçanik.

